

# FINANCA

DITARI MUJOR | SHTATOR 2024



## MINISTRI MALAJ MBLEDH KËSHILLIN TATIMOR, PREZANTOHET STRATEGJIA AFATMESME E TË ARDHURAVE 2024-2027

Nën drejtimin e Ministrit të Financave, Petrit Malaj, u zhvillua mbledhja e Këshillit Tatimor, me qëllim prezantimin dhe diskutimin e draft-Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave, 2024-2027, në kuadër të procesit të konsultimit publik të saj. Gjatë fjalës së tij, Ministri Malaj tha se drafti i Strategjisë është konsultuar

dhe dakordësuar me Bashkimin Evropian dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar, ndërsa përbën një parakusht që Shqipëria duhet të plotësojë në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian "Faciliteti për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor" (Growth Plan). Ministri i Financave theksoi faktin se strategjia nuk parashikon ndryshim të normave tatimore dhe garanton stabilitet fiskal për tatimpaguesit, ndërsa ka si objektiv kryesor rritjen e nivelit të mbledhjes së të ardhurave, nëpërmjet miradministrimit fiskal.

LEXO MË SHUMË

## MIRATOHET RISHIKIMI I BUXHETIT 2024, FINANCIME SHITESË NË SEKTORËT PRIORITARË

Kuvendi i Shqipërisë miratoi në seancë plenare Aktin Normativ nr.3 për ndryshimin e buxhetit të vitit 2024. Akti u prezantua para deputetëve nga Ministri i Financave, Petrit Malaj, i cili gjatë fjalës së tij u shpreh se përmes

Aktit Normativ reflektohen në buxhetin vjetor rishikime jo vetëm në zërin e të ardhurave, por edhe atë të shpenzimeve. Përmes Aktit sigurohet rritja e të ardhurave buxhetore me rreth 27.3 miliardë lekë dhe rritja po me 27.3 miliardë lekë e shpenzimeve buxhetore, ndërsa nuk ndryshohet deficitit buxhetor. Ministri theksoi faktin se me këto ndryshime sigurohen financime shtesë në sektorë prioritarë,

si infrastrukturë, bujqësi, arsim, shëndetësi, mbrojtje e siguri, duke mbështetur kështu nevojat e ekonomisë. Miratimi i tij, tha Ministri, është i rëndësishëm për mirëqenien e qytetarëve dhe vijimin e reformave të nevojshme, të cilat garantojnë financa publike të shëndetshme dhe një ekonomi të fortë dhe të qëndrueshme.

LEXO MË SHUMË



## MINISTRI MALAJ, KONFERENCË MBI SITUATËN MAKROEKONOMIKE DHE REALIZIMIN E TË ARDHURAVE



Ministri i Financave, Petrit Malaj, zhvilloi një konferencë për media, gjatë së cilës bëri një prezantim të treguesve kryesorë makroekonomikë dhe performancës së realizimit të mbledhjes së të ardhurave. Në fjalën e tij,

Ministri Malaj theksoi faktin se vendi ka shënuar një rritje ekonomike në masën 3.6% në tremujorin e parë të vitit, papunësia është ulur në nivelin 10.7%, paga reale është rritur në masën 10.8%, investimet e huaja direkte kanë shënuar stokun e 1.5 miliardë eurove në fund të vitit 2023, ndërsa janë rritur me 15.2% në tremujorin e parë të vitit 2024. Ministri pohoi se administrata tatimore dhe doganore kanë patur një performancë pozitive në mbledhjen e të ardhurave, ndërsa Ministria e Financave parashikon që borxhi publik të bjerë në nivelin 58.2% në fund të vitit 2024, nga 58.9% që ka ishte në fund të vitit 2023.

LEXO MË SHUMË

## SHQIPËRI-ZVICËR, MARRËVESHJE NË MBËSHTETJE TË SISTEMIT TË FINANCAVE VENDORE

Ministri i Financave, Petrit Malaj dhe Ambasadorja e Zvicrës në Shqipëri, Ruth Huber, nënshkruan marrëveshjen për mbështetje të mëtejshme teknike në sistemin e financave vendore



në vendin tonë. Marrëveshja mbështet fazën e dytë të projektit për "Ofrimin e asistencës teknike për Forcimin e Menaxhimit të Financave Publike në Nivel Vendor në Shqipëri" dhe parashikon një fond prej 4.5 milionë euro periudhën 2024-2028, në funksion të vazhdimit të zbatimit të projektit në fjalë. Ministri Malaj shprehu bindjen zbatimi i saj do të ndihmojë qeverinë shqiptare për të vijuar garantimin e: rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore; reformimit të buxhetit vendor, duke e bërë më eficient dhe transparent; si dhe kontrollit më të mirë të auditimit dhe raportimit financiar.

LEXO MË SHUMË

## PERFORMANCA PARAPRAKE E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PËR 8 MUJORIN 2024

Performanca paraprake e treguesve fiskalë të konsoliduar për periudhën Janar-Gusht 2024 reflekton ecurinë e mbledhjes së të ardhurave dhe realizimit të shpenzimeve. Të ardhurat totale, për periudhën 8-mujore, arritën në rreth 463.8 miliardë lekë ose 103.4% e planit të periudhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, u mblodhën rreth 38.2 miliardë lekë më shumë ose 9% më shumë se 8 mujori i vitit 2023. Shpenzimet e përgjithshme publike, për periudhën 8 mujore të vitit 2024, arritën në rreth 405.7 miliardë lekë me një realizim në masën 93.1 përqind të planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 ky zë ka rezultuar 7.4 përqind më i lartë ose rreth 27.8 miliardë lekë më shumë.

LEXO MË SHUMË



## SHQIPËRI-BE, ZHVILLOHET MBLEDHJA E 16-TË E NËNKOMITETIT PËR EKONOMINË, ÇËSHTJET FINANCIARE DHE STATISTIKAT

Nënkomiteti për Ekonominë, Çështjet Financiare dhe Statistikat mes Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian zhvilloi mbledhjen e 16-të, në Tiranë, ku pala shqiptare u kryesua nga Zëvendësministria e Financave, znj. Adela Xhemali ndërsa delegacioni i BE-së u kryesua nga Drejtori i Njësisë për vendet

kandidate në DG ECFIN, z. Uwe Stamm. Zëvendësministria theksoi rëndësinë e Nënkomitetit dhe ndau një informacion të përgjithshëm në lidhje me zhvillimet më të fundit ekonomike në Shqipëri, përfshirë këtu edhe rritjen ekonomike të vendit. Përfaqësuesit e palës shqiptare diskutuan mbi zhvillimet dhe perspektivat më të fundit gjatë kësaj periudhe lidhur me çështjet ekonomike, monetare dhe financiare të Shqipërisë, si dhe disa prej sfidave me të cilat është përballur vendi.

LEXO MË SHUMË

## ZËVENDËSMINISTRJA XHEMALI TAKOHET ME NJË GRUP INVESTITORËSH TË TREGJEVE NDËRKOMBËTARE FINANCIARE



Zëvendësministria e Financave, Adela Xhemali priti në një takim një grup investitorësh të rëndësishëm të tregjeve ndërkombëtare financiare, përfaqësues të kompanive si: Raiffeisen Bank International, T.Rowe Price, Danske Bank, etj. Qëllimi i takimit ishte diskutimi mbi zhvillimet më të fundit ekonomike në vend dhe në veçanti financat publike, si dhe pritshmëritë për të ardhmen. Investitorët shprehën një

interes të veçantë lidhur edhe me zhvillimet sa i përket procesit të anëtarësimit të vendit tonë në Bashkimin Evropian. Palët diskutuan edhe për projekte me interes të përbashkët, sfidat dhe masat që mund të ndërmerren për zbatimin e tyre me efikasitet.

LEXO MË SHUMË



## MINISTRI MALAJ TAKOHET ME PËRFAQËSUESIN E PËRHERSHËM RAJONAL TË FMN PËR BP

Ministri i Financave zhvilloi një takim me Përfaqësuesin e Përhershëm Rajonal të Fondit Monetar Ndërkombëtar për Ballkanin Perëndimor, z. Sebastian Sosa. Gjatë këtij takimi u diskutua mbi zhvillimet më të fundit ekonomike në vendin tonë dhe pritshmëritë për situatën makroekonomike. Ministri Malaj vlerësoi se bashkëpunimi me FMN është i një rëndësie të veçantë në drejtim të forcimit të financave publike dhe reformave që po zbaton qeveria shqiptare, ndërsa shprehu angazhimin e Ministrisë së Financave për të vijuar punën sa i përket konsolidimit fiskal dhe adresimin e sfidave të përbashkëta.

LEXO MË SHUMË

## MINISTRI MALAJ TAKOHET ME GUVERNATORIN SEJKO

Ministri i Financave zhvilloi një takim Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko. Gjatë këtij takimi u diskutua mbi zhvillimet më të fundit ekonomike në vendin tonë dhe pritshmëritë për të ardhmen. Ministri Malaj dhe Guvernatori Sejko biseduan mbi forcimin e bashkëpunimit mes Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë, në funksion ruajtjes së stabilitetit makroekonomik dhe financiar të vendit. Një tjetër temë diskutimi ishte dhe edukimi financiar, për të cilën u vlerësua rëndësia e ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi këtë fushë.

LEXO MË SHUMË



## MINISTRI MALAJ TAKOHET ME DREJTORESHËN E BERZH

Ministri i Financave priti në një takim Drejtoreshën e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Shqipërinë, Ekaterina Solovova. Gjatë këtij takimi, palët diskutuan mbi forcimin e bashkëpunimit mes Ministrisë së Financave dhe BERZH-it, me fokus në zhvillimin e sektorëve prioritarë, si: infrastruktura, energjia e rinovueshme, investimet e gjelbra, por edhe përmirësimin e klimës së biznesit. Ministri Malaj vlerësoi kontributin dhe mbështetjen e BERZH, veçanërisht sa i përket zhvillimit të qëndrueshëm të vendit tonë dhe axhendën e reformave në kuadër të integritimit evropian të Shqipërisë.

LEXO MË SHUMË

